

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BRUKA" AB

Neni 1

Shoqeria Private "BRUKA" AB formohet nga themeluesit :

- Josif Gorreja, i biri i Vangjelit, me dtl.1965, banues ne Divjake
- Nikoll Todi, i biri i Llambit , me dtl.1946, banues ne Divjake.

Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Divjake.
Shoqeria mund te ndryshoje seline saj me zgjerimin e aktivitetit me miratimin e ortakeve.

Neni 3

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj pa afat dhe mbi 10 vjet te mare si vite kalendarike duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin themeltar.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise :
Tregtim makineri , farera, prodhime, bujqesore , me shumice pakice, import eksport.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke i ndare 95 % per ortakun Josif Gorreja dhe 5 % ortaku Nikoll Todi. Ky kapital eshte plotesish sht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket.

Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalet e saj me miratimin e ortakeve themelues.

Neni 6

Pjeste e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve . Gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen edhe te treteve me miratimin e ortakeve.

Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve si dhe me rruge trashegimie.

1. KONTROLI
2. KONTROLI
3. KONTROLI
4. KONTROLI
5. KONTROLI

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

Neni 7

Shoqeria administrohet nga z. Josif Gorreja.

Neni 8

Mbledhjet e asamblese jane te zakonshme dhe te jashtezakonshme.

Mbledhjet e asamblese se zakonshme duhet te thiren te pakten nje here ne vit.

Neni 9

Asambleja mer keto vendime si e zakonshme : (kompetencat)

- Miraton statutin e shoqerise dhe rregulloren e brendshme te saj.
- Zgjedh administratorin e shoqerise.
- Vendos dhe analizon veprimtarine ekonomike dhe financiare te shoqerise.
- Ben pranimin e anetareve te riq.

Neni 10

Asambleja mer vendime si e jashtezakonshme :

- Per ndryshimin e statudit te shoqerise dhe aktit te krijimit.
- Per emerimin e personave te ngarkuar per likuidimin.

Neni 11

Administratori ka kopetenca per te vepruar me te tretet ne mardhenie, ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat.

Administratori ka te drejte te marre pjese ne shitblerje, procedure falimentimi, te hapet llogari te tundeshme e te patundeshme, te hape llogari rrjedhese prane bankave shqiptare e te huaja, te perfajsoje shoqerine ne organet gjyqesore e administrative.

I pajisur me prokure te posacme nga asambleja, administratori mund te kaperceje e te veproje edhe perteje kufizimi te siperpermendur ne kete nen.

Administratori merr te gjitha vendimet qe jane ne interes te punes dhe te prodhimit per probleme te emergjences.

Raporton dhe pergjigjet para asamblese per drejtimin e shoqerise.

Vendos per marrjen ne pune dhe largimin apo pushimin nga puna te personave qe ai ka nen vartesi administrative.

Administratori është unik. Ai mund të jetë njeri nga ortakët, ose një person tjetër.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
N) MANUSHAQE
NOTERI
LUSHNJE

THEMELUESIT E SHOQËRISE

JOSIF GORREJA

NIKOLL TODI

REPUBLIKA E SHQIPËRISE

NOTERIA LUSHNJE

NR. 1013 Rep.

NR. 897

Lushnje, me 20/05/1996

V E R T E T I M

Sot me datën 20/05/1996 para meje noteres Manushaqe Sharka

u paraqiten personalisht z. Josif Gorreja, i biri i Vangjelit, me dtl.1965, banues në Divjake, Nikoll Todi, i biri i Llabit, me dtl.1946, banues në Divjake, me zotesi të plote juridike për të vepruar, me identitetin e të cilve u njoha në bazë të dokumentave perkatese, të cilët deklaruan se kanë hertuar statutin dhe aktin e themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "BRUKA" AB, dhe mbasi e nënshkruajnë ato me vullnetin e tyre të lirë, une noterja e vertetoj.

NOTE RE

MANUSHAQE SHARKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
NOTE RE
MANUSHAQE SHARKA
NOTERIA LUSHNJE

STATUT I
S T A T U T I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "BRUKA" AB

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA

Neni 1

Shoqeria Private "BRUKA" AB formohet nga themeluesit :

- Josif Goreja, i biri i Vangjelit, lindur e banues ne Divjake, me dtl.1965.

- Nikoll Todi, i biri i Ilambit, me dtl.1946, lindur e banues ne Divjake.

Neni 2

Shoqeria eshte person juridik dhe eshte krijuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe si e tille e fillon aktivitetin e saj me regjistrimin ne regjistrin tregetar.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Divjake Lushnje.

Shoqeria mund te ndryshoje-seline e saj me zgjerimin e aktivitetit me miratimin e ortakeve.

Neni 4

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj , ne teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte tij. Shoqeria mund te krijojte filiale ne vende te tjera ne perputhje me legjislacionin perkates te atij vendi.

Neni 5

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar i perballon humbjet e saj deri ne kufirin e vleres se kapitalit te investuar ne te.

LIBRI I SHOQERISE.

Neni 6

Per te precizuar dhe per te saktesuar veprimtarine e vet ekonomike dhe mardheniet e punes shoqeria do te nxjerre librin e vet i cili do te quhet libri i shoqerise.

KONFIDENCIALITETI.

Neni 7

Ortaket dhe personat e pranuar ne shoqeri bien dakort qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem , informacionet qe do te disponoje shoqeria, kontratat qe ajo do te lidhe , si dhe planet dhe qellimet qe ajo ka per te ardhjen e saj.

Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentet e tjera qe do te nxiren nga shoqeria, te destinuara per te tretet, si letrat faturat, lajmerimet dhe publikimet e ndryshme , duhet te tregojne lexueshem emrin e shoqerise dhe pas tij fjalet " shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose iniciallet SH.P.K., kapitalin themeltar dhe emrin e administratorit.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE.

Neni 9

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj pa afat dhe mbi 10 vjet te mare si vite kalendarike , duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin themeltar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 10

Tregtim makineri, farera, prodhime , bujaesore , shumice pakice, import eksport.

KAPITALI THEMELTAR.

Neni 11

Kapitali thmeltar i shoqerise eshte 100 000 leke i ndare 95 % Josif Gorreja e 5 %Nikoll Todi.

Ky kapital eshte plotesisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket.

Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj me miratimin e ortakeve themelues.

Neni 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve ,Gjithashtu pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen edhe

te treteve , me miratimin e ortakeve.

Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne raste ndarje pasurore, me bashkeshorteve si dhe me rruge trashegimie.

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE.

Neni 13

Shoqeria do ta konsideroje qendren e vet si nene e cila rast pas rasti do te hapet me filiale te tjera.

Neni 14

Organi me i larte i drejtimit te shoqerise eshte asambleja e ortakeve.

Shoqeria administrohet nga Josif Gorreja.

ASAMBLEJA.

Neni 15

Mbledhjet e asamblese jane te zakonshme e te jashtezakonshme.

Mbledhjet e asamblese se zakonshme duhet te thiren te pakten nje here ne vit

Neni 16

Thirjet e asamblese behen me letra qe permbajne rendin e dites vendin dhe oren e mbledhjes derguar secilit ortak se paku 10 dite perpara, ose ne rast urgjente me telegram sepaku dy dite perpara.

Administratori duhet te njoftoje asamblene gjithashtu brenda 5 diteve kur ka marre kerkese nga ortaket ose nga njeri prej tyre qe perfaqeson sepaku 10 % te kapitalit te shoqerise dhe ne keto kerkese tregohen ceshtjet qe duhen trajtuar.

Asambleja drejtohet nga administratori i shoqerise neqoftese ajo nuk vendos ndryshe.

Administratori i shoqerise emerion nje sekretar (e) per te mbajtur proces verbalin.

Secili ortak mund te perfaqesohet me nje prokure te posacme me shkrim, nga nje person qe nuk eshte ortak.

Neni 17

Asambleja mer keto vendime si e zakonshme : (kompetencat)

- Miraton statutin e shoqerise dhe rregulloren e brendshme te saj.

LIBRI I SHOQERISE
LIBRE E SHARKA
SHKENCOR
1987
LIBRI I SHOQERISE
ADMINISTRIM

- zgjedh administratorin e shoqerise.
- Vendos dhe analizon veprimtarine ekonomike dhe financiare te shoqerise.

• Ben pranimin e anetareve te rinj te shoqerise.

Neni 18

Asambleja mer vendime si e jashtezakonshme :

- Per ndryshimin e statutit te shoqerise dhe te aktit te krijimit.
- Per emerimin e personave te ngarkuar per likuidimin.

Neni 19

Asambleja e zakonshme dhe e jashtezakonshme krijohet ne rastin e pare te takimit me prezencen e dy ortakeve, te cilet vendosin ne menyre te vlefshme me vota pro me aq ortake sa te perfaqesohet shumica absolute e kapitalit shoqeror.

LIBRAT E SHOQERISE, BILANCI, SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI.

Neni 20

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacionit kontabel q ose librave te tjere edhe keto libra :

- Libri i ortakut, ne te cilen shenohet emri i plote i tij dhe kuota e kapitalit themeltar.
- Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te organit vendimor.
- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit administrativ.

ADMINISTRIMI.

Neni 21

Administratori ka kopetence per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rrethanat.

Administratori ka te drejte te mare pjese ne shitblerje, procedure falimentimi, te tjetersoje pasuri te patundshme e tebtundshme, te hape llogari rrjedhes prane bankave shqiptare dhe te huajem te perfaqesoje shoqerine ne organet gjyqesore e administrative.

I pajisur me prokure te posacme nga asambleja, administratori mund te

te kaperceje e te veproje edhe perteje perkufizimit te siperpermendur ne kete nen.

Administratori mer te gjitha vendimet qe jane ne interes te punes dhe te prodhimit per probleme te emergjences.

Raporton dhe pergjigjet para asamblese per drejtimin e shoqerise.

Vendos per marjen ne pune dhe largimin apo pushimin nga puna te personave qe ai ka nen vartesi administrative.

Administratori eshte unik. Ai mund te jete njeri nga ortaket, ose nje person tjetër.

Neni 22

Administratori zgjidhet nga asambleja e ortakëve për një afat 2 vjeçar. Me mirëkuptimin e ortakëve ai mund të qëndrojë si i tillë edhe përtej këtij afati, me kusht shqyrtimin formal të kandidatures së tij menjëherë mbas mbarimit të mandatit 2 vjeçar. Kandidatura nuk është e perseritshme kur të paktën 40 % e kapitalit themelor e përfaqësuar nga një a me shumë ortakë nuk e mbështesin atë.

Administratori pushon veprimtarinë e vet kur :

- Jep dorëheqjen .

- Përfundon afatin.

- Shkel rëndë e në mënyrë të perseritur statutin, aktin e krijimit, akt marrëveshjen e ligjet e shtetit shqiptar.

ANETARËSIA (Te qenit ortakë)

Neni 23

Anetar i shoqerise quhet ai person i cili mer persiper direkt ne kapitalin themelor te shoqerise me te drejten e tij te pronesise mbi pjese te tij te njohur ligjerisht me akte ligjore, konform legjislacionit shqiptar.

Anetaresia ne pergjithesi eshte e drejte vetiake.

Kuotata e anetarit mund te transferohen me akte ndermjet te gjalleve nga ortaku tek bashkeshorti dhe farefisi. Ato mund ta transferohen edhe te tjereve. Gjithmone ne keto raste kerkohet miratimi i asamblese se ortakëve.

Anetari i shoqerise nuk mund te jete si i tillë në më shumë se një shoqeri me kete objekt veprimtarie.

Neni 24

Te drejtata e anetarit humbasin kur :

- Anetari largohet nga shoqeria me deshiren e vet.
- Zhvillon aktivitet te jashtem ekonomik qe bie ndesh dhe demton rende interesat e shoqerise apo i krijon ^{per} asaj perfitim personal situata renduese konkurruese.

Neni 25

Cdo anetar ka te drejte :

- Te zgjedhe e te zgjidhet ne organet e shoqerise.
- Te mare pjese ne veprimtarine prodhuese e shoqerise te SH.P.K.
- Te gezoje te ardhurat (fitimin) qe rrjedh nga aktiviteti i shoqerise.

BILANCI.

Neni 26

Bilanci mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. I pari do te jete ai i vitit 1996.

Llogarite vjetore , inventari, raportet mbi operacionte e vitit financiar dhe raportete e e hartuara nga eksperti kontabel, i autorizuar nga ortaket, mirato hen nga ata. Miratimi i ketyre dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej kater muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Dividentet.

Neni 27

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimit percaktohet pjese qe i tqkon ortakeve themelues ne formen e dividendit mbi fitimin.

Ky fitim perbehet nga fitimi i vitit financiar , te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te domosdoshem te percaktuar nga vete ortaket, te fondeve te tjera qe shihen te nevojshme dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet ~~nga~~ e martura nga vitet e meparshme.

SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE.

Neni 28

Shoqeria priset kur ka nje prishje te parakohshme te parashikuara ne ligj

Neni 29

Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi ortaket caktojme nje apo disa likuidues te cilet i paraqesin asamblese raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivitet te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatet e nevojshme te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likuidimit ortaket vendosin mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit. Pas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se kapitalit themeltar kontribues (nese ka te tille) likuiduesi ndan kapitalet per te dy ortaket themelues.

MARDHENIET PER PUNESIM.

Neni 30

Kriteret e pergjithshme te punesimit te personave te tjere, numurin e tyre, kufijte e pageses dhe detyrat e secilit ne shoqeri, percaktohen nga ortaket.

Punesimi i personave ne shoqeri kryhet mbi bazen e kontrates individuale te punes, te hartuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Neni 31

Shoqeria mer persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te sigurimeve shoqerore per te gjithë te punesuarit, ndersa keta te fundit duhet te pranojne kete statut.

Te punesuarit pergjigjen sipas ~~kyje~~ ketij statuti per moszbatimin e detyrave dhe per demet qe ata i shkaktojne shoqerise.

Neni 32

Te gjitha mosmarveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit, qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve do te tentohen te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kopetente shqiptare konforme legjislacionit shqiptar.

DISPOZITA TE FUNDIT.

Neni 33

Shtimi i ortakeve.

Kur ortaket jane dakort qe te behen shtesa kapitali me ane te personave te tjere, qe keta te konsiderohen ortake duhet te veprohet keshtu :

- Se pari : meret vendim nga ortakët themelues , ku shqyrtohet kërkesa e te interesuarit , behet pranimi dhe percaktohet kuota e kapitalit qe do te derdhe ortaku i ardhshem.

- Se dyti : behet regjistrimi ne librin e ortakut, ku shkruhet emri i plote i ortakut te ri dhe kuota ne kapitalin e shoqerise.

- Veprimi i bashkimit me ortakun e ri duhet te behet me nje akt noterial.

Neni 34

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimit te metejshem me ane amendamentesh sa here qe e shohin te arsyeshme ortakët themelues te kesaj shoqerie.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre dhe procedure me te cilen behet vete nxjerja e ketij statuti.

Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik te shoqerise.

Ky statut eshte hartuar ne pese kopje shqip e pasi lexohet e gjendet ne perputhje me vullnetin e paleve nenshkruhet prej tyre rregullisht.

ORTAKËT E SHOQERISE

JOSIF GORREJA



NIKOLL TODI

